



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. BrProt Prot No 01-423/15
Nr. ffaq Broj stranica 02	Data Datum 18-02-2015
Nr. pages	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.02.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 3971/14, për z. Bilbil Oruçi – Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK - 03-3971/14, për zyrtarin e lartë z. Bilbil Oruçi – Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast z. Oruçi, është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Qendrën për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “KONAKU” dhe person i autorizuar në biznesin tjetër privat “ABC”.

Fillimisht zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë, për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Oruçi është bindur për kufizimin si pronar dhe person i autorizuar në bizneset private dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare, të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 –388/15 dhe DPKI 03 –389/15), me të cilat vërtetohet se ka bërë ndryshimet e nevojshme. Me këtë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

